



ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

## KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU KUKËS

“Varfëria dhe pasojat e saj mbi fëmijët dhe të drejtat e tyre” për vitin 2011



### QARKU KUKËS

Eksperti Rajonal  
**Shkëlqim Muça**

## LISTA E SHKURTIMEVE

INSTAT	– Instituti i Statistikave
SHSSH	- Shërbimi social shtetëror
ACA	- Aleanca Për Fëmijët në Shqipëri
NJDF	- Njësia për të Drejtat E fëmijëve
DSHP	- Drejtorinë e Shëndetit Publik
DAR	- Drejtorinë Arsimore Rajonale
PBB	- Prodhimi i brendshëm bruto
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Kukës
NjMFF	- Njësia për mbrojtjen e fëmijës dhe familjes
NJDF	- Njësia për te drejtat e fëmijëve
ZA	- Zyra arsimore

## Hyrje dhe falënderime

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është një iniciativë ndërmjet UNICEF dhe Aleancës për Fëmijë, që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Observatori për të drejtat e fëmijëve është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Kukësit në vitin 2008, e cila në bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë realizon mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

Observatori për të drejtat e fëmijëve ka bashkëpunuar në nivel qarku me të gjitha njësitë vendore, administratorët social në bashki/komuna, institucionet arsimore dhe shëndetësore, njësitë për të drejtat e fëmijëve në bashki/komuna, Njësinë për të Drejtat e Fëmijëve në këshillin e qarkut dhe organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Që nga fillimi i punës së tij observatori për të drejtat e fëmijëve ka bërë të mundur sensibilizimin e të gjithë aktorëve në qark që të luajnë një rol më aktiv në promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Observatori ka bërë analizë periodike të të dhënave të grumbulluara si dhe ka vlerësuar situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal dhe rajonal. Nëpërmjet punës së observatorit, duke pasur si detyrë të tij mirëmbajtjen dhe rifreskimin e bazës së të dhënave, shoqëria civile ka identifikuar problemet më kritike që cenojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve. E gjithë kjo përpjekje e Observatorit për të drejtat e fëmijëve është realizuar falë bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe shëndetësore, organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, punë e cila është arritur falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që punojnë me fëmijët.

Mirënjohje e veçantë për bashkëpunimin me Observatorin Kukës shkon për përfaqësuesit e administratës publike lokale dhe personave të kontaktit në Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore Has dhe Tropojë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Qarkut Kukës, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Spitalit Kukës, Zyrës së Statistikave pranë qarkut Kukës, Njësinë për të drejtat e fëmijëve në Qarkun Kukës, njësite e qeverisjes vendore.

Për realizimin e këtij studimi “Varfërinë dhe pasojat e saj mbi fëmijët dhe të drejtat e tyre”, falënderojmë administratorët sociale në bashkinë Krume Z. Shani Kastrati, në bashkinë Kukes Z.Vladimir Trota, në komunën Gjinaj Z.Haxhi Asllani, në komunën Bicaj Z. Ernit Kerxhaliu, për bashkëpunimin e pakursyer për hartimin e këtij raporti.

Një falënderim shkon për stafin drejtues të projektit Observatori për të Drejtat e Fëmijëve znj. Suzana Sakiqi (Koordinatore kombëtare –ACA), znj. Elma Tërshana (Drejtoreshë Projekti), Znj. Mina Mata (Administratore Kombëtare për të dhënat), Znj. Ermira Zace (Administratore dhe Financiere) për mirëkuptimin dhe mbështetjen që na kanë dhënë gjatë realizimit të studimit.

## Hyrje

Realizim i studimit “Varfërinë dhe pasojat e saj mbi fëmijët dhe të drejtat e tyre”, synon të analizojë situatën social-ekonomike, si dhe si ndikon varfëria tek fëmijët për vitin 2011 në Qarkun e Kukësit.

Për të pasqyruar nëpërmjet një analizë sa më të mire të situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve dhe një analizë e të dhënave ne nivel lokal, informacioni që ka të bëjë me faktorët e ambientit, zonën gjeografike gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor 2012 janë realizuar takime me fokus grupe në Bashkinë Kukës dhe Krumë si dhe Komunitat Bicaç dhe Gjinaj, ku në fokus të këtyre takimeve janë trajtuar këto çështje;

1. Cilat janë Njësitet matëse të varfërisë
2. Cilët janë faktorët që ndikojnë në varfërinë fëmijëve,
3. Ndikimi i varfërisë në jetën dhe të ardhmen e fëmijëve, Shërbimet që përfitojnë familjet e varfra falas,
4. Sa është buxheti që shkon për këto familje,
5. Sa dhe si ndikon varfëria në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve,
6. Sa dhe si ndikon varfëria në frekuentimin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë,
7. Politikat për reduktimin e varfërisë tek fëmijët;

Analiza e studimit përfshin të dhëna dhe informacione që i përkasin vitit 2011. Ky studim do të ofrojë gjithashtu dhe: analizën e gjendjes së përgjithshme të të drejtave të fëmijëve në rajon duke u fokusuar tek gjendja e tyre social – ekonomike, informacion të thelluar për grupet e fëmijëve në nevojë, aksesin në shërbime si dhe rekomandime për të ardhmen. Ky raport, synon që tu vijë në ndihmë dhe t’ju shërbejë të gjitha njësive vendore, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, njësive për të drejtat e fëmijëve në bashki/komuna, organizatave joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut Kukës; Në mënyrë të veçantë, ky studim ndihmon 4 njësitet vendore në të cilat është realizuar studimi<sup>1</sup>, në artikullimin e planeve dhe strategjive për garantimin e të drejtave të fëmijës, duke u bazuar në situatën social ekonomike të tyre.

Për hartimin e këtij raporti është mbledhur informacion me anë të fokus grupeve dhe pyetësorëve; Janë shqyrtuar gjithashtu dhe materiale e studime kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur në fokus varfërinë dhe përjashtimin social të grupeve të ndryshme dhe fëmijëve. Janë mbledhur informacione nga Drejtoria e SHSSH Kukës, DAR, INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe studime dhe raporte të hartuara nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Studimi është mbështetur në të dhëna sasiore të cilat janë të grumbulluara direkt nga fokus grupet por edhe nga burime të tjera të përmendura më lart; nga pyetësorët e drejtuara familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike, por edhe të dhëna cilësore të grumbulluara nga intervistimet me aktore të ndryshme të përfshirë në fokus grupe. Analiza e të dhënave sasiore është bërë sipas elementëve të statistikës përshkruese ndërsa ato cilësore përmes teknikave të përpunimit të informacionit të natyrës cilësore.

---

<sup>1</sup> Katër njësitet vendore ku është realizuar studimi janë: Bashkitë Kukës dhe Krumë, Komunitat Bicaç dhe Gjinaj.

***Treguesit e analizuar:***

- Numri i familjeve ne skemën e ndihmës ekonomike për vitet 2009-2011
- Numri i fëmijëve qe jetojnë në familje me ndihme ekonomike
- Fondi qe kanë përfituar familjet me ndihme ekonomike dhe fëmijët që jetojnë në familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Për të pasur një informacion të drejtë për drejtë nga fëmijët dhe familjet e tyre që jetojnë në varfëri (në formën e fokus grupeve), janë realizuar *5 fokus grupe*, përkatësisht në Bashkinë Kukës (2), në Bashkinë Krumë (1), në Komunën Bicaç (1) dhe në komunën Gjinaj (1). Këto fokus grupe janë realizuar gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor 2012.

Për këtë raport janë angazhuar specialistë të fushës së shërbimeve sociale në 4 njësi vendore të përzgjedhura për vlerësimin e situatës social ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

## 1. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Qarku i Kukësit shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe ka në përbërjen e tij 27 njësi vendore, nga të cilat 24 komuna dhe 3 bashki. Qendra administrative, politike, ekonomike dhe kulturore e qarkut është qyteti i Kukësit. Popullsia e qarkut Kukës në fund të vitit 2011 ishte 107.756 banorë, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes civile; Ndërsa sipas shërbimit Social Shtetëror Kukës, qarku Kukës numëron 26,535 familje, nga të cilat 12,269 trajtohen me ndihmë ekonomike ose 46,4 %. Vlera totale në lekë që këto familje kanë përfituar gjatë vitit 2011 është 584.500.000 lekë, në formën e ndihmës ekonomike (Burimi Shërbimi Social Shtetëror)<sup>2</sup>. Në qarkun e Kukësit mbizotërojnë moshat e reja. Fëmijët e moshës 0-18 vjeç përbëjnë 30.6 % të popullsisë së përgjithshme të qarkut (33.037) për vitin 2011.

Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Punësimit<sup>3</sup>, në fund të vitit 2011 janë regjistruar 8,661 persona të papunë.

Pjesa më e madhe e fëmijëve të qarkut u përkasin familjeve me ndihmë ekonomike ku në këto familje jetojnë 26.992<sup>4</sup> fëmije ose 81% e tyre trajtohen me ndihme ekonomike. Numri i personave që jetojnë në familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike përbejnë 71% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së qarkut (76.506 persona u përkasin 12,269 familje përfituese të Ndihmës Ekonomike).

Një fakt që evidentohet nga punonjësit e njësive vendore të Qarkut Kukës, është se familjet të cilat janë vlerësuar për tu trajtuar me **ndihmë ekonomike të plotë janë të privuar** nga përfitimi 100% i kësaj ndihme. Kjo ndodh për shkak të krizës financiare në vend, pasi fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit nuk vjen i plotë pranë SHSSH-së, duke e bërë Institucionin që të bëjë një ndarje pak a shumë të barabartë mes bashkive dhe komunave.

Bazuar në një vlerësim për matjen e nivelit të Jetesës (2005, 2008) nga INSTAT<sup>5</sup>, si dhe në studime dhe analiza të tjera të realizuara gjatë këtyre viteve, - kanë treguar se administrimi i programit të ndihmës ekonomike përballet me vështirësi të cilat ndikojnë në uljen e efektivitetit të tij. Në mënyrë të ngjashme, sistemi ekzistues i ndihmës ekonomike mund të sigurojë të ardhurat e nevojshme për të varfrit, por ai nuk i ndihmon të varfrit që të shpëtojnë nga varfëria.

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë me të rrezikuarit nga përjashtimi social. Ata vuajnë disavantazhe të shumëfishta sociale, sepse kanë mundësi të kufizuara në sigurimin e strehimit, arsimit cilësor, kujdesit të përshtatshmen shëndetësor pjesëmarrje shoqërore dhe mbrojtje. Po tu referohemi shifrave në qarkun e Kukësit për tre vitet e fundit (2009, 2010, 2011), numri i familjeve që trajtohen në skemën e ndihmës ekonomike ka ardhur në rritje.

Përtej varfërisë së drejtpërdrejtë ekonomike, përjashtimi i tyre shoqëror bën që të drejtat e tyre themelore të kërcënohen nga pasiviteti i detyruar, paaftësia për të arritur potencialin e tyre të plotë dhe për të ndërtuar marrëdhënie njerëzore që mund t'i udhëheqin drejt pjesëmarrjes aktive qytetare.

<sup>2</sup> DRSHSSH Kukës Nentor 2012

<sup>3</sup> Drejtoria rajonale e Punësimit Qershor 2012

<sup>4</sup> ZRSHSSH Kukës

<sup>5</sup> INSTAT: LSMS 2005.2008

Edhe pse vlerësohet se Shqipëria ka një rritje të qëndrueshme ekonomike, prej 4% deri 6%<sup>6</sup> në vit, gjatë dekadës së fundit, varfëria mbetet shqetësim serioz. Sipas treguesve ekonomike të Shqipërisë për vitin 2011, PBB është në nivelin US\$ 4.050 për frymë, e cila është vlere më e ulët në rajon)<sup>7</sup>.

Ndonëse përqindja e popullsisë e vlerësuar si e varfër, u zvogëlua nga 25 % në vitin 2002 në 12% në vitin 2008, dinamika e ndryshimit të treguesve të varfërisë ka ndryshime të mëdha midis rajoneve të vendit. Sipas INSTAT<sup>8</sup> zona malore ka nivelin më të lartë të varfërisë me 26.6%, por me e përkeqësuar situata e varfërisë brenda rajonit malor është në zonat rurale. Aktualisht varfëria rurale paraqitet në shifrat 104% me e larte krahasuar me te gjitha rajonet e tjera rurale në Shqipëri.

Shërbimet sociale për kategoritë në nevojë janë të përqendruara në bashkinë Kukës. Ndërsa në njësitë e tjera vendore të Qarkut Kukës nuk ka shërbime të tilla me përjashtim të një zyre shërbimesh (personi kontakti). Në bashkinë Bajram Curri ndodhet zyra, e cila funksionon me një person për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjen, pavarësisht se pretendohet që ajo luan rolin e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në Bajram Curri.

Duke mos pasur një shpërndaje të shërbimeve dhe mungesa të një qendre ditore për fëmijët në nevojë, në bashkinë Krumë dhe Bajram Curri, kemi:

- një rritjen të rrezikut shoqëror për përjashtim social për grupet e marginalizuar,
- detyrohen fëmijët nga prindërit për të punuar,
- pamundësi e fëmijëve për t'u angazhuar në aktivitete rekreative.
- Etj.

Me mbështetjen financiare të UNICEF si dhe "ALB-AID" në Kukës janë ngritur:

- Sektori i përkujdesjes shoqërore pranë qarkut.
- Njësia e monitorimit të drejtave të fëmijëve pranë qarkut
- Zyra e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Kukës,

Qarku Kukës, në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe me iniciativën e UNICEF, ka qenë një ndër qarqet e para të Shqipërisë që ka hartuar Strategjinë Rajonale dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2006-2011; duke u bërë kështu pionier i vendosjes së mekanizmave demokratik institucional për politikë bërjen lokale drejtuar fëmijëve.

Shoqata ALB-AID ka dy vite që po zbaton projektin për fuqizimin e Njesisë për të Drejtat e Fëmijës dhe ka organizuar një sërë aktivitete mbi identifikimin dhe referimin e fëmijëve në risk.

Si rezultat i lëvizjeve masive të popullatës drejt zonave fushore e urbane, në fshat ka rënë ndjeshëm numri i nxënësve për klasë. Në këto kushte janë krijuar klasa kolektive, ku dy-tri klasa zhvillojnë mësim me të njëjtin mësues në lëndë të ndryshme. Kështu, vetëm në rrethin e Kukësit mësojnë në klasa kolektive 2,223 fëmijë<sup>9</sup> ose 22% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, prej të cilëve 1,460 në ciklin e ulët dhe 763 në ciklin e lartë. Duke marrë parasysh faktin që shumë

<sup>6</sup> Te dhena të INSTAT 2012

<sup>7</sup> Burimi: Te dhena të publikuara nga Banka e Shqipërisë

<sup>8</sup> INSTAT: Trendi i varfërisë në Shqipëri

<sup>9</sup> DAR Kukës Tetor 2012

familje tw varfra për shkak të pamundësisë së lëvizjes jetojnë në zonat rurale si dhe rritjen e klasave kolektive, është ulur ndjeshëm cilësia e arritjeve të nxënësve.

Në Qarkun e Kukësit, për vitin 2011 rezultojnë 755 fëmijë me aftësi të kufizuar (207 fëmijë të grupmohës 0-6 vjeç; 349 6-15 vjeç; 199 15-18 vjeç). Prej tyre 298 janë femra (93 të moshës 0-6 vjeç, 131 të moshës 6-15 vjeç dhe 74 të moshës 15-18). Të dhënat e mësipërme të përkthyer në përqindje, përlllogaritet që 2 % e numrit të fëmijëve janë me aftësi të kufizuar në Qarkun e Kukësit për vitin 2011; Nevojat e tyre të veçanta, kryesisht janë: të verbër, para e tetraplegjikë dhe me paaftësi mendore dhe fizike. Ndërkohë, numri i personave kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara është 604, të cilët janë të privuar nga mundësia për të kërkuar punë tjetër me pagë më të mirë për veten dhe familjen e tyre, për të zhvilluar potencialet e tyre në shoqëri apo për të gëzuar jetën si të gjithë të tjerët. Për këtë kategori fëmijësh, për qarkun e Kukësit, për vitin 2011 janë akorduar 82 446 000 lekë ose 9100 lekë për person në muaj.

**Tabela 1:** Shpenzimet për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike në Qarkun Kukës për vitet 2009, 2010 dhe 2011;

**Burimi:** ZRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave ne këto familje	Numri i fëmijëve ne këto familje	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)	Buxheti për një fëmijë (ne 000 leke)
a	b	c	d=c*4.2	e=c*2.2	f=(b/d)*e	g=b/f
2009	530,800	11,360	47,712	24,992	278.038	11.12
2010	571,000	12,718	53,416	27,980	299.097	10.68
2011	584,500	12,269	51,530	26,992	306.167	11.34

Nga 26,535 familje<sup>10</sup>, që ka qarku Kukës 12,269 trajtohen me ndihmë ekonomike ose 46,4 %. Vlera totale në lekë që këto familje kanë përfituar gjatë vitit 2011 është 584.500.000 lekë, Siç shihet dhe nga tabela numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në shkallë qarku vazhdon të jetë e lartë.

Treguesit e mirëqenies (varfërisë) së familjeve ndërtohen mbi bazën e tabelave dhe e treguesve të veçantë. Në rastin tonë për të karakterizuar varfërinë e familjeve kemi marre në konsiderate familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Është marre në analizë kjo kategori e familjeve sepse këto familje konsiderohen në varfëri ekstreme duke u nisur nga kriteret dhe treguesit që duhet të plotësojnë familjet për të përfituar ndihmë ekonomike.(Ligji 9355 datë 10.03.2005 Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore).

Për të kryer përlllogaritjet, për të dhënat në shkallë qarku, jemi mbështetur në tezen se “fëmija i varfër jeton në familje të varfër”.

Në strategjinë kombëtare për fëmijë 2005-2010, përkufizimi i varfërisë së fëmijëve jepet si më poshtë: Varfëria është pamundësi e personave për të shpenzuar të paktën 5,722 lekë në muaj për frymë në vitin 2008 (ose 6,130 lekë në vitin 2011). Duke analizuar të ardhurat që shkojnë për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe fëmijët që jetojnë në këto familje në qarkun Kukës, rezulton se niveli i të ardhurave për frymë është më i ulët se 120 USD në muaj. Sipas

<sup>10</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile



përkufizimit të varfërisë së fëmijëve i bie që për një fëmijë që jeton në familje që trajtohet me ndihme ekonomike që të shpenzojë **vetëm për një vit aq sa është minimumi jetik për dy muaj**.

Sipas INSTAT, treguesit më të rëndësishëm të niveli të varfërisë janë: përqindja e popullsisë që jeton në varfëri absolute ( e përcaktuar në Shqipëri si numri i personave me konsum mujor real nën 4.891 lekë) dhe përqindja e popullsisë që jeton në varfëri ekstreme (e përcaktuar si numri i personave që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave baze ushqimore).

Zonat me varfëri ekstreme në rajon janë komunat: Zapod, Malzi, Surroj, Ujmishit të rrethit Kukës, Gjinaj të rrethit Has, Fierzë, Bytyç e Lekbibaj të rrethit Tropojë ku 80% familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike. Kukësi numëron 1650 subjekte fizike dhe juridike të cilat kanë të (vet)punësuar 1650 punonjës. Në sektorin shtetëror janë punësuar 6,060 punonjës (arsim, administratë, shëndetësi). Te vetmet biznese janë ata të kafeneve dhe bareve. Të ardhurat e emigrantëve dhe grantet e qeverisë janë burimet e vetme për të zbutur varfërinë.

Ekonomia bazohet kryesisht në sektorin e bujqësisë që prodhon vetëm për mbijetesë ekonomike. Nga studimi i nivelit të jetesës (LSMS 2002)<sup>11</sup> rezulton se 86 % e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin e detyruar në rajonin e Kukësit i përkasin zonave të thella malore dhe 61 % prej tyre familjeve të skemës së ndihmës ekonomike.

Në qarkun Kukës numërohen rreth 33,037 fëmijë<sup>12</sup> apo një e katërta e popullsisë. Shfrytëzim i fëmijëve nga prindërit apo familjarët e tyre në punët e përditshme në tregun lokal, bujqësi në zonat rurale, është tepër evidente. Në disa shkolla si në Borje, Shishtavec, Novosej fëmijët pengohen nga prindërit në fillim të vitit shkollor të frekuentojnë normalisht shkollën për shkak të angazhimit të tyre në punët bujqësore që lidhen me pikun e mbledhjes së patates në muajt shtator – tetor.

Ketë fakt e pohojnë dhe vete fëmijët nga një anketim i realizuar nga shoqata ALB-AID në vitin 2011, ku rezultoi se nga 197 nxënës të anketuar në 7 shkolla të tre rrethëve të qarkut 21% e tyre kryesisht në fshatra (pasi cilësohet se lloji i punës është bujqësia) punojnë pas procesit mësimor dhe kjo ka ardhur si një nevojë për tu përballur me kushtet e vështira ekonomike.

Në rajonin e Kukësit numërohen 1,585 fëmijë jetim nga të cilët 47 jetimë biologjik, kurse 1,538 jetimë me një prind, prej të cilëve 872 në rrethin e Kukësit, 290 në Tropojë dhe 376 në Has.

Fëmijët jetim përbejnë 3,9 % të fëmijëve të grupmoshës 0-14 vjeç, prej të cilëve 0,01 % janë jetimë biologjik dhe 3,8 % janë fëmijë jetimë me një prind. Pjesa më e madhe e kësaj kategorie jeton në një varfëri ekstreme, pasi këta fëmijë mbahen nga të afërmit e tyre dhe duke qenë familje vetë në nevoje e kanë të pamundur të plotësojnë nevojat e këtyre fëmijëve.

Sistemi shëndetësor në Qarkun e Kukësit kryesisht është publik. Shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve që i ofrohen popullatës në fushën e promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Sektori privat mbulon shërbimin farmaceutik, dhe në pjesën më të madhe të Qarkut atë stomatologjik . Funkcionojnë klinika diagnostikuese për sytë, analiza gjaku, të cilat janë kryesisht të përqendruar në qytetin e Kukës.

Shërbimi shëndetësor diagnostikues dhe kurues është i organizuar në dy nivele:

- Shërbimi parësor dhe

<sup>11</sup> Studimi i nivelit të jetesës , (LSMS 2002)

<sup>12</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

- Shërbimi spitalor dytësor.

Shërbimet e shëndetit publik dhe promocionit ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor. Mbështeten dhe mbikëqyren nga DSHP.

- Funksionon DSHP (Drejtoria e Shëndetit Publik) e cila koordinon të gjitha shërbimet shëndetësore të qarkut. Si drejtori të veçanta funksionojnë: Drejtoria spitalore dhe Drejtoria e kujdesit shëndetësor parësor.
- Në qarkun e Kukësit niveli shërbimit shëndetësor përfaqësohet nga 4 qendra spitalore (2 në Kukës, 1 në Bajram Curr 1 në Krumë) dhe 3 shtëpi lindje (1 për çdo rreth) Pranë qendrës spitalore të Kukësit funksionon dhe poliklinika e specialiteteve.

Në komuna shërbimi shëndetësor ofrohet në qendra shëndetësore dhe shërbimi ambulator.

Qendrat shëndetësore<sup>13</sup> përballën me mungesën e medikamenteve te domosdoshme, mungesë të ambienteve për konsultor të fëmijëve dhe të gruas, mungesë ambienti për dhomë rihidrimi<sup>14</sup> për fëmijët 0-6 vjeç, mungesë uji të rrjedhshëm, mungesa në infrastrukture si tavolina karrige. Kjo gjendje e shërbimit shëndetësor në komuna vështirëson edhe më tepër jetën e familjeve në këto zona, pasi janë të detyruar të ecin me kilometra për në qytet për të marrë shërbimin shëndetësor më të specializuar.

### **1. Bashkia Kukës<sup>15</sup>**

Bashkia Kukës për vitin 2011 numëron 4,222 familje nga të cilat 2,071 trajtohen me ndihmë ekonomik, ose 49% e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike duke u renditur ndër Bashkitë më të varfra në vend. Programi kryesor i pagesave në kesh (të holla) është ndihma ekonomike, e cila mbështet familjet me të ardhura të pakta ose pa të ardhura. Sipas këtij programi, pushteti qendror, ne bazë të kërkesave për fonde, u shpërndan bashkive dhe komunave bllok-grante të kushtëzuara për mbulimin e nevojave të familjeve të varfra. Njësitë e qeverisjes vendore i administrojnë këto fonde nëpërmjet marrjes dhe kontrollit të aplikimeve sipas rregullave që përcakton pushteti qendror për pranimin dhe përfitimin e ndihmës ekonomike.

Burimet e financimit të ndihmës ekonomike përbëhen nga:

1. Fondet e buxhetit qendror të shtetit
2. Fondet nga taksat dhe tarifat vendore

Bashkia Kukës për vitin 2011 ka financuar për qendrën e shërbimeve sociale 3% te buxhetit vjetor. Edhe pse kjo shume është e pamjaftueshme në krahasim me nevojat, kjo është një gjë pozitive pasi të paktën mendohet për këtë kategori në nevojë.

Programi i Ndihmës Ekonomike mbështet me pagesë mujore familjet pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme. Alokimi i fondeve të ndihmës ekonomike bëhet mbi bazën e treguesve statistikorë që dërgohen nga njësitë e qeverisjes vendore. Këto të fundit paraqesin nevojat për fonde duke u mbështetur në strukturën e familjeve përfituese si dhe në të ardhurat që siguron familja nga toka dhe veprimtaritë e tjera prodhuese. Kjo ndihmë është “e plotë” kur familjet përfituese nuk kanë të ardhura, dhe “e pjesshme” kur familjet pretenduese kanë të ardhura të pamjaftueshme. Buxheti i akorduar nga shteti për këtë program u delegohet njësitëve të qeverisjes vendore në formën e një grandit të kushtëzuar.

*Asnjëherë buxheti i akorduar nga shteti nuk vjen i plotë pranë SHSSH-së, i cili është i detyruar që të bëjë një ndarje pak a shumë të barabartë mes bashkive dhe komunave.*

<sup>13</sup> Nga vizita në qendrat shëndetësore në komuna të qarkut observator i për të drejtat e fëmijëve gjatë muajit dhjetor 2012;

<sup>14</sup> Dhomë rihidrimi përdoret për rastet e fëmijëve me probleme të jashtëqitjes;

<sup>15</sup> Të dhëna dhe informacionet nga terreni janë mbledhura gjatë muajit Dhjetor 2012 në Bashkia Kukës;

**Tabela 2:** Shpenzimet për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike në Bashkinë Kukës për vitet 2009 dhe 2011;


**Burimi:** ZRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave ne këto familje	Numri i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (në 000 leke)	Buxheti për fëmijët (në 000 leke)
a	b	c	$d=c*4.2$	$e=c*2.2$	$f=(b/d)*e$	$g=b/f$
2009	96.084	1.780	7.476	3.916	50.329	12.85
2010	103.086	1.917	8.051	4.217	53.994	12.80
2011	103.388	2.071	8.698	4.556	54.154	11.88

Nga të dhënat në tabelë shihet qartë se për 3 vite rresht *ka rritje* të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe rënie të të ardhurave vjetore që shkojnë për fëmijët pasi është rritur numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Për vitin 2011 edhe pse *u rrit* numri i familje me ndihme ekonomike fondi total i akorduar për këtë vit nuk pati rritje.

**Grafiku 1:** Numri i familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në familje me NE në Bashkinë Kukës 2010-2011



Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike ka pësuar rritje nga viti 2010 në 0.9% në vitin 2011. Në bashkinë Kukës për vitin 2011 numërohen 5763<sup>16</sup> fëmijë ku 4556 fëmijë jetojnë

<sup>16</sup> Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile 2012

në familje me ndihme ekonomike ose 79% e tyre. Vetëm në shkollën 9-vjeçare “Avni Rrustemi” në bashkinë Kukës nga 925 nxënës që ka shkolla 388 prej tyre jetojnë në familje me ndihme ekonomike.

Varfërinë nuk do ta shohim vetëm në mungesën e të ardhurave por dhe në mungesën e shërbimeve pasi shërbimet që ofrohen për fëmijët ne nevojë janë shumë të kufizuara. Edhe pse shërbimet sociale të qarkut janë të përqendruara tërësisht në bashkinë Kukës, ato janë të kufizuara për një numër të vogël përfituesish. Aktualisht në Bashkinë Kukës funksionon qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, e ngritur në vitin 2007 me fond të Bankës Botërore nga organizata ASED fillimisht e financuar nga Kantonet e Zyrihut dhe të Bernes në Zvicër dhe që nga tetori i vitit 2009 nga bashkia Kukës. Kjo qendër ofron shërbim për 12 fëmijë me aftësi të kufizuar për vitin 2011.

**Tabela 3:** Buxheti dhe numri i fëmijëve që kanë frekuentuar, për vitet 2010 - 2011, qendrën e Shërbimeve sociale në Bashkinë Kukës.

**Burimi:** Bashkia Kukës Dhjetor 2012;

Vitet	Qendra sociale Bashkia Kukës		
	Nr. Fëmijëve	Fonde	Buxheti për fëmijë (000 / lekë)
a	b	c	d = c / b
2010	12	2.013	167.7
2011	12	2.013	167.7

Sipas NJMDF në bashkinë Kukës janë evidentuar 163 fëmijë në nevojë, 32 fëmijë me prind të divorcuar, 153 fëmijë jetim me një prind, 16 fëmijë në konflikt me ligjin.

Gjithsesi duhet të përmendim se edhe kur referohen rastet për fëmijët në nevojë apo rrezik, ka shumë burokracira, pasi duhet të plotësohen një sërë dokumentesh që rasti të marrë rrugën e zgjidhjes. Mund të përmendim rastin e një fëmijë në bashkinë Kukës i cili kishte më shumë se 2 vjet që mbahej i lidhur me zinxhirë nga gjyshja e saj. Edhe pas shumë përpjekjeve dhe thirrjeve për referimin e tij në qendrat e specializuara u desh publikimi i rastit në emisionin “Fiks fare” që ky problem të merrte zgjidhje në muajin shtator të vitit 2012.

Gjatë vitit 2011 në Bashkinë Kukës shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar ishte 100%<sup>17</sup>; Kjo pjesëmarrje e plote është një aspekt shumë pozitiv por nuk mund ta mohojmë faktin se në shkollë shkojnë fëmijë të paushqyer mire, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

## 2. Bashkia Krumë;<sup>18</sup>

E njëjta panoramë paraqitet dhe në Bashkinë Krumë nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Shërbimeve sociale pranë Bashkisë Krumë ku për vitin 2011 rezultoi se nga 1,564 familje që ka bashkia Krumë 670 prej tyre trajtohen me ndihmë ekonomike ose 43%. Në krahasim me vitin 2010, ka një rritje prej 9% të familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike. Kjo ka ndikuar direkt në uljen e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe indirekt në përkeqësimin e situatës për fëmijët që jetojnë në këto familje duke i detyruar shpesh herë që të braktisin edhe mësimin për të siguruar të ardhura. Edhe pse ka rritje të fondit vjetor për ndihmën ekonomike, në total nuk ka

<sup>17</sup> DAR Kukës Tetor 2012

<sup>18</sup> Te dhenat të mbledhura nga drejtoria e ndihmes ekonomike në Bashkinë Krumë Dhjetor 2012;

sjelle rritje të të ardhurave për përfituesit pasi rritja totale ka shkuar për përfituesit që janë futur në skemën e ndihmës ekonomike.

**Tabela 4:** Shpenzimet për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike në Bashkinë Krumë për vitet 2009 dhe 2011;

**Burimi:** ZRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave ne këto familje	Numri i fëmijëve ne këto familje	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)
a	b	c	$d=c*4.2$	$e=c*2.2$	$f=(b/d)*e$	$g=b/f$
2009	35,068	630	2,646	1,386	18,369	13.25
2010	34,620	616	2,587	1,355	18,134	13.38
2011	34,620	670	2,814	1,474	18,134	12.30

Sipas Drejtorisë së përgjithshme të gjendjes civile, në bashkinë Krumë për vitin 2011 numërohen 2,972 fëmijë 0-18 vjeç, fëmijë të grup-moshës 0-6 vjeç 774, të grup-moshës 6-15 vjeç 1,386, të grup-moshës 6-15 vjeç 812. Në këtë njësi vendore ka 4 kopshte, 3 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor vazhdon të jetë e ulët, vetëm 36%<sup>19</sup> e fëmijëve të grup-moshës 0-6 vjeç në bashkinë Krumë frekuentojnë arsimin parashkollor. Ndërsa e kundërta ndodh në përfshirjen e nxënësve në arsimin e detyruar dhe të mesëm që paraqitet në nivele të larta, shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar është 91% dhe në arsimin e mesëm 98%. Sipas të dhënave të zyrës së statistikave pranë Zyrës arsimore Has për vitin 2011 raportohen vetëm 2 fëmijë që kanë braktisur shkollën. Në fakt kjo shifër është e pa qartë pasi vetëm në një familje në Krumë 5 fëmijë nuk vijnë shkollën për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Kjo kontradiktë në paraqitjen e shifrave nga institucionet lokale tregon gjendjen e vështirë dhe mungesën e zbatimit të ligjit për arsimin gjithëpërfshirës.

Rasti i mëposhtëm shpjegon qartë këtë situatë të përshkruar më sipër:

#### **I. J 13 vjeç në bashkinë Krumë;<sup>1</sup>**

Kam qenë nxënës i shkollës 9-vjeçare “Niman Ferizi” Krumë por ka 2 vjet që nuk shkoj më në shkollë, kushtet e vështira ekonomike të familjes time nuk më lejojnë që të vazhdoj më tej shkollën, mundohem sadopak të ndihmoj familjen duke shitur qumështin për të siguruar të ardhura, po ashtu dhe motra me e madhe se unë dhe 2 vëllezërit e tjerë nuk shkojnë në shkollë, kam dëshirë që të shkoj por nuk më lënë prindërit pasi me thonë që s’kemi mundësi që të blejmë rroba.


Nga intervistat dhe diskutimet në fokus grupe rezulton se në bashkinë Krumë:

- Mungojnë shërbimet për grupet vulnerabel,
- 60 familje rezultojnë të pastrehë dhe janë nga familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- 50 familje jetojnë në varfëri ekstreme ku fëmijët e këtyre familjeve e kanë të vështirë të ndjekin mësimin rregullisht, për shkak të gjendjes së vështirë të këtyre familjeve fëmijët e tyre janë të detyruar të mos vazhdojnë shkollën me tej pas mbarimit të arsimit 9-vjeçar dhe të punojnë kryesisht në pika interneti dhe në lokale.

<sup>19</sup> Syra Statistikës ZA Has Tetor 2012;

**Grafiku 2:** Numri i familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në familje me NE në Bashkinë Krumë 2010-2011

**Burimi:** Zyra e ndihmës ekonomike në Bashkinë Krumë;



Numri i fëmijëve që jetojnë në familje që trajtohen me ndihme ekonomike është 49% në bashkinë Krumë.

Zyrtarë pranë Bashkisë shprehen se nuk kemi pasur në dispozicion fonde për të ndihmuar këto familje përveç trajtimit të familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Në buxhetin e pushtetit lokal nuk ka asnjë zë të veçantë për mbështetjen e familjeve të varfra dhe mungojnë programet të veçanta për këtë kategori.

### 3. Komuna Bicaj:<sup>20</sup>

Në komunën Bicaj për vitin 2011 numërohen 1,712 familje ku 834 familje trajtohen me ndihmë ekonomike ose 49%.

**Tabela 5:** Shpenzimet për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike të Komunës Bicaj për vitet 2009 dhe 2011;

**Burimi:** ZRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave ne këto familje	Numri i fëmijëve ne këto familje	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)
a	b	c	d=c*4.2	e=c*2.2	f=(b/d)*e	g=b/f
2009	27684	789	3313	1735	14501	8.35
2010	27564	819	3439	1801	14438	8.01
2011	27549	834	3502	1834	14430	7.86

<sup>20</sup> Te dhenat për tre vitet e fundit të mbledhura përgjatë muajit Dhjetor 2012 në Komunën Bicaj

Megjithëse komuna u ka akorduar ndihmën ekonomike 100 % këtyre familjeve, ato shprehen se kjo ndihme është e pamjaftueshme për përballimin e nevojave të përditshme.


Në komunën Bicaç ka 6 kopshte publike, të cilat frekuentohen nga 192 fëmijë, 7 shkolla 9-vjeçare me 1,079 nxënës dhe 1 (një) shkollë të mesme me 336 nxënës. Mungojnë programet e shërbimit për të ardhur në ndihme këtyre grupeve të fëmijëve. Nga të dhënat e zyrës së urbanistikës në komunë, 50 shtëpi banimi rrezikohen nga shembja. Në këto 50 shtëpi jetojnë afërsisht 95 fëmijë të cilët jetojnë çdo ditë me frikën e shembjes së banesës. Fakti që këto familje nuk kanë mundësi të riparojnë shtëpitë e tyre tregon qartë se këto fëmijë jetojnë në një varfëri e cila ndikon direkt në zhvillimin e tyre. Ashtu si dhe njësitë e tjera vendore, dhe komuna Bicaç gjatë vitit 2011 nuk ka dhënë asnjë fond të veçantë për fëmijët në nevojë edhe pse nga intervista me administratorin social pranon që në komunën Bicaç janë 95 fëmijë që kanë nevojë dhe jetojnë në familje me varfëri ekstreme dhe kanë nevojë për mbështetje.

Familjet që ndodhen në kushte të vështira ekonomike, kanë vështirësi për të dalë nga kjo situatë, pasi ato sigurojnë shumë pak të ardhura nga zënia me punë në bujqësi dhe sipërfaqja e tokës që ata disponojnë është shumë e vogël.

Papunësia është një faktor tjetër që ka ndikuar në uljen e të ardhurave për familje si dhe në rritjen e numrit të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Rritja e numrit të familjeve në nevojë ka dhënë efektet e saj negative, dhe në drejtim të cilësisë dhe arritjeve të këtyre fëmijëve në shkollë duke çuar deri në pamundësinë për të vazhduar më tej atë.

Sipas tabelës 5 duket qartë rritja e numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike duke ulur ndjeshëm shumën mujore në para që shkon për këto familje.

Grafiku 3; Numri i familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në familje me NE në Komunën Bicaç 2010-2011



Për vitin 2011 numri i fëmijëve në këtë njësi vendore rezulton të jetë 2908 ose 63% e fëmijëve në komunën Bicaj jetojnë në familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.

#### 4.Komuna Gjinaj:

Në Komunën Gjinaj mekanizmi për hartimin e këtij studimi, ishin takimet me fokus grupe, ku në këto takime morën pjesë kryepleqtë të fshatrave, përfitues të ndihmës ekonomike, punonjës të shëndetësisë. Në komunën Gjinaj, identifikohen 7 familje me 25 fëmijë<sup>21</sup> në gjendje të vështirë ekonomike varfëri ekstreme. Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike vetëm 50% e nxënësve që mbarojnë arsimin e detyruar vazhdojnë ciklin më të lartë pasi familjet e tyre nuk kanë mundësi të përballojnë transportin për në shkollë.

**Tabela 6:** Shpenzimet për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike të Komunës Gjinaj për vitet 2009 dhe 2011;

**Burimi:** ZRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave ne këto familje	Numri i fëmijëve ne këto familje	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)	Buxheti për fëmijët (ne 000 leke)
a	b	c	d=c*4.2	e=c*2.2	f=(b/d)*e	g=b/f
2009	12336	240	1008	528	6461	12.23
2010	13902	265	1113	583	7281	12.48
2011	14845	285	1197	627	7775	12.40

Aktualisht Komuna Gjinaj është një ndër komunat më të varfra të qarkut të Kukësit.


Në vitin 2011, nga 335 familje që ka komuna 285 prej tyre përfitojnë ndihmë ekonomike. 85% e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike. Numri i fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje me ndihmë ekonomike për vitin 2011 është 627, në krahasim me vitin 2010 kemi një rritje me 0,9% të fëmijëve që jetojnë në familje me ndihmë ekonomike.

**Grafiku 4:** Numri i familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në familje me NE në Komunën Gjinaj 2010-2011;

**Burimi:** Zyra ndihmes ekonomike Komuna Gjinaj;

<sup>21</sup> Te dhena të marra nga administratori Social komuna Gjinaj Dhjetor 2012;





Nga takimi me fokus grupet në këtë njësi vendore u kërkua që e vetmja mënyre për te ndihmuar këto familje dhe fëmijët e tyre për të dalë nga gjendja e vështire ekonomike, kërkohet mbështetja me programe të veçanta dhe ndihma të jepet për fëmijët që frekuentojnë shkollën si një stimulim dhe zbutjen sadopak të pasojave të varfërisë.

Mungesa informacionit dhe e një rrjeti shërbimesh shoqërore komunitare mund të përsërisë rastin e ngjarjes tragjike të vitit 2003 të familjes Zyberi banore e komunës Gjinaj, ku humbi jetën nga i ftohti një nga vogëlushet e kësaj familje. E theksojmë këtë rast pasi nga vëzhgimet tona ka akoma fëmijë që janë në rrezik për jetën, si rasti i një familjeje tjetër në këtë komunë ku, - 2 fëmijë jetojnë vetëm me të atin i cili është në moshë të thyer dhe vuan nga çrregullime mendore. Vetëm njeri nga fëmijët vazhdon shkollën ndërsa tjetri nuk shkon në shkollë pasi është i detyruar të punojë për te siguruar të ardhura për familjen.

Një tjetër shqetësim është mungesa e fondeve të kësaj njësie vendore për të mbështetur familjet me probleme sociale. Me problematiken që përballen fëmijët në komunën Gjinaj kërkohet një mbështetje më e madhe nga komuna dhe OJF-ve për sigurimin e nevojave bazë për familjet në nevojë.

Treguesi<sup>22</sup> i përqindjes se fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute sipas LSMS-së, me zero dollarë të ardhura, është 1.8%; ndërsa fëmijë që jetojnë në familje me më pak se 120 USD në muaj (që do të thotë me pak se 1 USD në ditë për person) janë 17.4%.

Duke marrë në konsideratë numrin e fëmijëve që jetojnë në familje të varfra si dhe tendencën në rritje të tyre ( nisur nga numri i familjeve në skemën e NE gjatë tre viteve të fundit), vijmë në konkluzionin se numri i fëmijëve të varfër ne qarkun e Kukësit ka pësuar rritje.

<sup>22</sup> INSTAT:Shqipëria-Trendi I varfërisë LSMS Prill 2009

Kjo rritje është e evidente në të katër njësitë vendore të përfshira në këtë studim, si në numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike ashtu dhe të fëmijëve që jetojnë në këto familje. Ajo që është për tu theksuar se me rritjen e numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, kemi një rënie të të ardhurave vjetore të tyre.

Sipas opinionit të të intervistuarve ata shohin si problem ligjin Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i cili sipas tyre ka mangësi pasi përjashton disa grupe që kanë realisht nevojë. Masa e ndihmës ekonomike rezulton të jetë e ulët duke mos plotësuar nevojat as për ushqim, për pasojë lë shumë familje në varfëri ekstreme.

Disa prej pasojave të varfërisë që ndikojnë drejtpërdrejt tek fëmijët janë:

- rritja e rrezikut shoqëror për grupet vulnerable dhe pa përkrahje,
- përjashtim social për grupet e pamundura,
- rrezikshmëria e lartë ndaj trafikimit e abuzimit,
- shkelja masive e të drejtave,
- dhuna dhe abuzimi në familje,
- rritja e kriminalitetit,
- braktisja e shkollës e analfabetizmi sidomos te vajzat në zonat rurale,
- detyrimi i fëmijëve nga prindërit për të punuar,
- pamundësi e fëmijëve për t’u angazhuar në aktivitete rekreative,
- rritja e shkallës së prekjes nga sëmundjet e ndryshme,
- kequshqyerja e fëmijëve,
- pabarazi gjinore, keqinformimi,
- diferencimi kulturor mes fëmijëve etj.

### **Analizë e kuadrit ligjor:**

Kuadri aktual ligjor ka krijuar hapësira të mjaftueshme për të hartuar politika rajonale dhe plane të ndryshme veprimi. Kështu si ligji Nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore ” ashtu dhe ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” krijojnë hapësirat e nevojshme për të ndërtuar politika me efikasë lokale për fëmijët, i ndryshuar në ligjin nr 10 399 datë 17.03.2011.

Po kështu edhe Miratimi i Ligjit Nr 10347 ka krijuar edhe bazën e plotë ligjore për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave përkatës për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve. Megjithatë në Kukës me mbështetjen e UNICEF janë pilotuar si NJFM ashtu edhe NJDF para se të dilte ky ligj. Njëkohësisht qarku dhe Bashkia kanë nxjerrë vendimet përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Gjithashtu është fuqizuar NJDF dhe janë organizuar një sërë trajnimesh për te rritur kapacitetet e administratoreve social për të identifikuar dhe referuar rastet e fëmijëve në rrezik.

Gjatë vitit 2011, në zbatim të ligjit 10 347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” jo në të gjitha njësitë vendore të qarkut kanë ngritur Njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, edhe pse ligji e ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e pushtetit lokal për ngritjen dhe funksionimin e këtyre zyrave.

Në nivel qarku janë zbatuar një sërë projektesh:

- “Aktivizohuni në veprimtaritë e shkollës nëse doni që zëri juaj të dëgjohet dhe vota juaj të numërohet.”
- Organizimi i kampeve verore.
- Fuqizimi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Familjes NjMFF

- Observatori për të drejtat e fëmijëve
- Qendra e shërbimit ditor për fëmijët me aftësi të kufizua.
- Qendra sociale pranë bashkisë Kukës që ofron shërbime për 12 fëmijë me aftësi të kufizuar.
- Që prej vitit 2011 me financim të UNICEF shoqata ALB-AID po zbaton projektin për ngritjen dhe fuqizimin e Njesisë për të Drejtat e Fëmijëve.

## Prezantimi i gjetjeve kryesore

- Mungojnë shërbimet për grupet vulnerabel në: bashkinë Krumë, komunën Gjinaj dhe Bicaç.
- 20 fëmijë nga fshati Pus i Thatë detyrohen të ecin me shume se 5 kilometra në këmbë për të ndjekur mësimin.
- Në komunën Gjinaj, 50% e nxënësve që mbarojnë arsimin e detyruar nuk vazhdojnë arsimin e mesëm pasi familjaret e tyre nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e transportit.
- Në bashkinë Krumë, 50 familje jetojnë në varfëri ekstreme ku 112 fëmijët e këtyre familjeve e kanë të vështirë të ndjekin mësimin rregullisht, për shkak të gjendjes së vështirë të këtyre familjeve fëmijët e tyre janë të detyruar të mos vazhdojnë shkollën me tej pas mbarimit të arsimit 9-vjeçar dhe të punojnë kryesisht në pika interneti dhe në lokale.
- Në komunën Bicaç, 95 fëmije jetojnë çdo ditë me frikën e shembjes së banesës.
- Në disa shkolla të komunave, si në: Borje, Shishtavec, Novosej fëmijët pengohen nga prindërit në fillim të vitit shkollor të frekuentojnë normalisht shkollën për shkak të angazhimit të tyre në punët bujqësore që lidhen me pikun e mbledhjes së patates në muajt shtator – tetor.
- Nuk merren masa për parandalimin e rasteve të fëmijëve në rrezik nga administratoret sociale por ndërhyhet shumë me vonese pasi ka ndodhur ngjarja.
- Me përjashtim të bashkisë Kukës në asnjë njësi vendore nuk është ndare fond i veçantë për të mbështetur familjet e varfra.

## Rekomandime:

- Të gjitha njësite vendore të hartojnë një plan veprimi për fëmijët.
- Njësite vendore të ndajnë nga buxhetet e tyre lokale një fond të veçantë për të mbështetur kategoritë e fëmijëve në nevoje.
- Të rishikohet mënyra e dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevoje.
- Bashkëpunimi i njësite vendore me organizata të ndryshme, fondacioneve etj për të punuar për rritjen e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve për fëmijët.
- Njësitë e qeverisjes vendore duhet të intensifikojnë përpjekjet për marrjen e përgjegjësisë financiare dhe ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me dinamikën e nevojave të fëmijëve në nevojë në komunitet e tyre.
- Në të gjitha njësite vendore duhet të fuqizohen mekanizmat që përcakton ligji 10 347 date 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.